VENDIM
Nr. 151, datë 28.5.2026

MBI DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 174, DATË 29.8.2024, "MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË 'FAETHON' SHPK NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE", I NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; të nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë"; si dhe të nenit 15, të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 28.5.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1696 prot., datë 26.5.2026, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës "Mbi disa ndryshime në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 174, datë 29.8.2024, 'Mbi licencimin e shoqërisë 'Faethon' sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike', i ndryshuar",

konstatoi se:

1. Të dhëna mbi shoqërinë "Faethon" sh.p.k.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 174, datë 29.8.2024, i ndryshuar me vendimin nr. 317, datë 12.12.2025, vendosi të licencojë shoqërisë "Faethon" sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 78.6 mw ac, me vendndodhje në zonën kadastrale nr. 2444, Bashkia Libohovë, qarku Gjirokastër, për një afat 25-vjeçar.

- Në pikat 2 dhe 3 të vendimit përcaktohet se shoqëria duhet të fillojë ushtrimin e aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik, jo më vonë se data 14.2.2027, si dhe të depozitojë në ERE një kopje të aplikimit pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit për pajisjen me VNM paraprake të rinovuar, brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

2. Analiza ligjore dhe vlerësimi

- Shoqëria, me shkresat e protokolluara në ERE me nr. 170/38 prot., datë 28.1.2026 dhe nr. 170/77 prot., datë 2.2.2026, ka bërë me dije se janë në pritje për marrjen e lejeve përkatëse të zhvillimit dhe ndërtimit, por nuk rezulton që të ketë depozituar sa është kërkuar në pikën 3, të vendimit të Bordit nr. 174/2024, të ndryshuar.

- Detyrimi i përcaktuar në pikën 2 të vendimit, për të filluar ushtrimin e veprimtarisë brenda datës 14.2.2027, lidhet me afatet e përcaktuara në pikën 1, germa "d", të vendimit të Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 67, datë 14.2.2024 dhe nenit 9, pikës 2 të kontratës të nënshkruar me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) dhe rezulton se shoqëria është brenda këtij afati.

- Por në rrethanat kur nga shoqëria nuk është depozituar brenda afatit sa lënë detyrë në pikën 3, të vendimit nr. 174, datë 29.8.2024, të ndryshuar, për depozitimin e një kopjeje të aplikimit për pajisje me VNM të rinovuar dhe centrali nuk është ndërtuar ende, vlerësohet që të bëhet pezullim i vendimmarrjes së licencimit, duke ndryshuar pikën 1, të vendimit të bordit nr. 174/2024, të ndryshuar, deri në depozitimin në ERE të VNM-së paraprake të re, por jo më vonë se data 14.9.2026, duke marrë në konsideratë dhe kohën që nevojitet për ndërtimin dhe vënien në operim të centralit brenda afatit 14.2.2027.

- Në këto rrethana, vlerësohet të shfuqizohet pika 2, në lidhje me fillimin e operimit dhe pika 3, e cila tashmë propozohet të integrohet si pjesë e pikës 1.

3. Nevoja për ndryshimin e vendimit

- Në nenin 113, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", parashikohet se një akt administrativ mund të ndryshohet, shfuqizohet apo anulohet, kryesisht nga organi publik që ka kompetencë për ta nxjerrë atë.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Miratimin e disa ndryshimeve në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 174, datë 29.8.2024, i ndryshuar, si vijon:

a) Pika 1, e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 174, datë 19.8.2024, ndryshon dhe bëhet:

"1. Të pezullojë vendimmarrjen për licencimin e shoqërisë "Faethon" sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 78.6 mw AC, me vendndodhje në zonën kadastrale nr. 2444, Bashkia Libohovë, qarku Gjirokastër, deri në depozitimin në ERE të VNM-së paraprake të re, por jo më vonë se data 14.9.2026.";

b) Pika 2, e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 174, datë 19.8.2024, shfuqizohet;

c) Pika 3, e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 174, datë 19.8.2024, shfuqizohet.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së origjinës të njoftojë shoqërinë "Faethon" sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, shoqërinë "Operatori i Sistemit të Transmetimit" sh.a., shoqërinë "Furnizuesi i Tregut të Lirë" sh.a. dhe shoqërinë "Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike" (ALPEX) sh.a. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti